

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Dua Bio Box” SH.P.K

Në këtë statut:

- “Ligi” është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është ky statut i shoqërisë;
- “QKR” është Qendra Kombëtare e Regjistrimit e cila është themeluar dhe vepron në bazë të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

KAPITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, SELIA, DHE HAPËSIRA NË INTERNET

Neni 1: Themelimi

(1) Sot, me 11 /05 / 2021 (dymije e njezet e nje), ne mbeshtetje te legjisacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjt Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Dua Bio Box" shpk

(2) Ortaket themelues i shoqerise jane:

- Z. Federico Carniel, shtetas italian, i biri i Giampiero, i lindur me 17.04.1974, ne Milano, dhe banues ne Milano, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes italiane me nr. YB7295624;
- znj. Ilda Hila, shtetase italiane, e bija e Simonit, lindur me 07.03.1991, ne Lezhe dhe banuese ne Milano, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtese e dokumentit te identitetit me nr. AX9332727;
- znj. Miranda Hila, shtetase italiane, e bija e Prenges, lindur me 17.02.1968, ne Lezhe dhe banuese ne Milano, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtese e dokumentit te identitetit me nr. CA16852EB.

Neni 2: Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka si objekt tregtine online, me shumice dhe pakice te:

- Produktave ushqimore te fresketa, te konservuara dhe sidoqofte te pergatitura dhe konfekcionuara, duke perfshire buken, qumshtin dhe derivatet e tij;
- Produkte te perimeve te fresketa, te konservuara dhe sidoqofte te pergatitura dhe konfekcionuara, produkte te tjera ushqimore, sidoqofte te konservuara, para-konfekcionuara, vajra dhe vajra ushqimore me origjine vegjetale, veze;
- Embelsira te fresketa, te konservuara dhe sidoqofte te pergatitura dhe te konfekcionuara, duke perfshire edhe ne per gjithesi pasticerine dhe akulloret;
- pije te cdo lloji, duke perfshire ujin mineral, produkte alkolike dhe jo alkolike, pije freskuese dhe cdo produkt tjeter per konsum te njerezve dhe kafsheve, duke perfshire produktet e bulmetit dhe sidoqofte qe derivojne nga quimeshti dhe nga cdo lloj tjeter ushqimor;
- Produkte mishi te te gjitha specieve te kafsheve te fresketa, te konservuara, te ngrira dhe sidoqofte te pergatitura dhe konfekcionuara, sallame, produkte te tjera ushqimore me baze mishin dhe vezen
- Peshku dhe produktet e peshkut, te fresketa, te konservuara dhe sidoqofte te pergatitura dhe konfekcionuara, duke perfshire molusqet, butaket dhe anfibet;
- Produkte te perimeve dhe ne per gjithesi produkte te tokes, edhe duke iu referuar sektorit te bimeve (lule, bime, bulbe, pleh)

- Artikuj per bujqesine dhe per luleshitesit, lule te thata dhe artificiale, paketime, makineri dhe pajisje per bujqesine, artikuj per dhurata
- vazo, nenshtresa te kultivimit dhe gjithe çka te beje me veprimtarine e kopshtarise dhe garden center (arredime, vazo per shtepine dhe kopshtin e te tjera)
- deteritive te konfekcionuara, sapune, kozmetike, detergjente per pastrim personal dhe te shtepise, produkte higjenike - sanitare, insekticide, perfume;
- veshje ne per gjithesi dhe aksesore, te brendshme, produkte tekstile te çdo lloji, tekstile per shtepine, kinkaleri , artikuj lekure, bizhuteri;
- artikuj per shkollen dhe libra, lodra, artikuj per dhurate, bomboneri dhe aksesore, arredimi per shtepine dhe artikuj shtepiake ne per gjithesi, elektroshtepiake, aparatura radio dhe televizote, aparatura per riprodhimin e zerit dhe figures, materiale elektrike, artikuj te ndryshem
- deteritive, higjenike per shtepine dhe personin, karbone, kashta, bar ne per gjithesi, ushqime, insekticide, fertilizues, bojra, bojra vaji, hollues dhe penela, produkte kimike industriale, adezive, ngjites, materiale termike, zarfa natyralisht te shperbeshme, kontenitore, rroba pune (kemisha, doreza, cizme, maska, kapele, kaska, syze mbrojtese), materiale kunder aksidenteve, copa pambuku, produkte per depurimin e ujit, gelqere ne gjendje te lenget dhe pluhur, instrumente dhe reagente per industrine ushqimore.

Shoqeria mund te lidhe kontrata agjencie dhe / ose perfaqesimi, te ushtroje veprimitari prodhimi, riciklimi, transformimi, konfekcionimi si dhe dhenie me qira dhe import = eksport te produkteve si me siper.

Shoqeria ka gjithashtu si objekt:

- Veprimitari te transportit te mallrave në emër të palëve të treta, veprimitaritë e transportit dhe dergesave në per gjithesi, kombëtare dhe ndërkombëtare, nga toka, deti dhe ajri, me mjetet e veta dhe me mjetet e palës së tretë, ashtu si depozitimin, logistikën, ruajtjen, levizjen dhe shperndarjen per llogari te te treteve te mallrave te huaja, te komunitetit, apo kombetare;
- veprimitari te dhenies me qira te mjetete te transportit, me ose pa shofer, si edhe veprimitari te ndermjetesit te transporteve dhe te gjitha veprimitarite dhe sherbimet e lidhura me transportin dhe dergesat tokesore, detare, ajrore;
- Menaxhimi i minimarketeve, supermarketave dhe hipermarketave ose ushtrimi i tregtise me pakice per struktura te mesme dhe te medha te shitjes;
- çdo veprimitari tjeter te lidhur dhe te ngjashme me veprimitarite dhe produktet e renditura me siper Shoqëria gjithashtu mund të kryejë, direkt dhe indirekt, të gjitha operacionet tregtare, industriale, ato që lidhen me pasuritë e tundshme, ato të patundshme dhe pasuritë financiare që lidhen me objektin e vetë shoqërisë.

Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me ndalimet, kufizimet, kushtet dhe autorizimet e parashikuara në ligj dhe në Statut.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohezgjatja e veprimitarise ekonomike e Shoqerise Tregtare "Dua Bio Box" sh.p.k eshte e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.

Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

- (1) Shoqëria e ka selinë ligjore te regjistruar në adresën: Tirane, Rr. Abdyl Frasher, P. 31, kati 3, Tirane.
- (2) Shoqëria mund të zhvillojë veprimitarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

KAPITULLI II

Kapitali dhe kuotat

Neni 5: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100 (njeqind) Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 3 (tre) kuota te zotëruara nga ortaket e shoqerise si ne vijim:

- z. Federico Carniel, zoteron 1 kuote, te barabarte me 30% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;
- znj. Ilda Hila, zoteron 1 kuote, te barabarte me 60% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;
- znj. Miranda Hila, zoteron 1 kuote, te barabarte me 10% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimitnga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës sëadministratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushteqë kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit qëpërfaqësojnë.

Neni 7: Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyremund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

E drejta e parablerjes do te jete e ushtrueshme ne rast te shitjes se kuotave sipas sa percaktuar ne nenin 8 vijues.

Neni 8: Kalimi i kuotave me kontratë

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe vetëm me akt notarial dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratorët. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë ne seline e saj ligjore.

(2) Ne rastin e transferimit me akt midis te gjalleve, rezervohet ne favor te ortakeve te tjere e drejta e parablerjes.

Per kete qellim ortaku qe ka ndermend te shese teresisht ose pjeserisht kuotat e tij duhet te njoftoje me ane te letres rekomande ortaket e tjere, duke sakesuar çmimin dhe modalitetet te tjera te shitjes.

Ortaket e tjere mund te behen bleres te kuotave te ofruara ne proporcion me kuotat e shoqerise te zoteruara nga ata.

Brenda tridhjete nga komunikimi i bere nga ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, ortaket e tjere duhet te komunikojne nese kane ndermend te ushtrojne te drejten e parablerjes.

Pasi ka skaduar ky afat dhe asnje ortak nuk ka kerkuar blerjen e kuotave, e drejta e parablerjes do te quhet e ezauruar.

Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, transferimi tek te tretet jo ortake eshte sidoqofte i varur nga miratimi i ortakeve te tjere;

Ne hipotezen e mospelqimit, atehere kur nuk tregohet emri i bleresit tjeter me kushte te njejtë, ortaku ka te drejten e terheqjes.

Shoqeria mban, nen kujdesin e administratoreve, me te njejtat modalitetet e vendosura nga ligji per librat e tjere te shoquerise, librin e ortakeve, ne te cilin duhet te tregohen emri dhe adresa e ortakeve, pjesemarrja qe i perket secilit, derdhjet e bera per kuotat, ndryshimet ne personat ortake, si edhe, kur njoftohet, adresa e tyre e telefaksit dhe posta elektronike, per qellimet e vendosura nga ky statut.

Transferimi i pjesemarrjes dhe krijimi i te drejtave reale mbi to kane efekt ndaj shoquerise qe nga momenti i regjistrimit ne librin e ortakeve, qe do te kryhen nen kujdesin e administratoreve pas depozitimit ne regjistrin e shoqerive sipas ligjit.

(3) Asambleja e ortakeve me vendim te kualifikuar mund te mos pranoje qe administratoret/i te regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së nëse kuota objekt i shitjes nuk ka qenë shlyer tërësisht në kapitalin e shoqërisë.

(4) Nëse Asambleja nuk pranon te regjistrohet kalimi i kuotës, administratoret/i brënda një muaji pas datës në te cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njoftimin për mospranimin.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9: Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetete te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël te autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" tëkësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirëpërgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- l) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga njëortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund te veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cilapërfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 10: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohetnga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazhelektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohettë gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen easamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrëvendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11: Kuorumi

Punimet e mbledhjes nuk mund te fillojne nese nuk eshte i pranishem kuorumi i kerkuar ne vijim te ketij statuti. Sipas ketij neni, duhet një kuorum pjesemarrje prej 75% te ortakeve me te drejte vote per mbledhjet e asamblese se pergjithshme qe trajtojne ceshtje qe, sipas ligjit, nuk kerkojne një shumice te kualifikuar, me perjashtim te rastit kur ligji parashikon taksativisht ndryshe

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicëtë kualifikuar ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse eshte i pranishem një kuorum prej 100% te ortakeve me te drejte vote me perjashtim te rastit kur ligji parashikon taksativisht ndryshe.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumin tëpërmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite dhe me te njejtat kuorume.

Neni 12: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 100% te votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me 100% pjesëmarrës, për çështjet e tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen epasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Asambleja e përgjithshme mund te vendose me një shumice me te ulet nga sa percaktuar me siper nese kjo kerkohet ne menyre taksative nga ligji

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skedene shoqerise.

Neni 13: Përjashtimi nga e drejta e votës

I.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimpër:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 14: Administrimi



(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë tëshoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdoemërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 15: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblene e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


Neni 16 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljetë ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratoridetyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin mëtë mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;



- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen eqëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprimose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, mepërashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me takanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kurshkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë nëmënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'idiemshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "PerTregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti finansiar-ekspertet


Neni 17: Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti ipare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 18: Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qeka.



Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 19: Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi iveprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prejti emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen eaftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20: Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 21: Baza Ligjore


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dheshoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 22: Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetekompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Dua Bio Box" shpk


Federico Carniel


Ilda Hila


Miranda Hila